



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.180

dhjetor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9843 datë 17.12.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar	5605
Ligj nr.9844 datë 17.12.2007	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar	5608
Ligj nr.9845 datë 17.12.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”	5611
Ligj nr.9846 datë 17.12.2007	Për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të parcelave në ekonominë pyjore Krastë-Krujë, që do të përdoren për ndërtimin e fabrikës së çimentos e për kariera nga shoqëria “GENER 2” sh.p.k.....	5612
Ligj nr.9847 datë 17.12.2007	Për miratimin e “Marrëveshjes minerare të shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “GENER 2” sh.p.k. dhe ndryshimin e destinacionit të tokës bujqësore, të përcaktuar në këtë Marrëveshje, në tokë për shfrytëzim minerar”	5615
Ligj nr.9848 datë 17.12.2007	Për disa shtesa në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar	5633
Vendim i Kuvendit nr.152, datë 27.12.2007	Për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Lulzim Basha	5635
Dekret nr.5557 datë 27.12.2007	Për lejim lenie të shtetësisë shqiptare	5635

Dekret nr.5558 datë 27.12.2007	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	5636
Dekret nr.5559 datë 27.12.2007	Për disa ndryshime në dekretin nr.5351, datë 11.6.2007 “Për krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore”	5637

LIGJ
Nr.9843, datë 17.12.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998
“PËR URBANISTIKËN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 17 paragrafi i parë, fjalët “drejtori i Policisë së Ndërtimit ose një punonjës i propozuar prej tij” zëvendësohen me fjalët “inspektori i inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut, i propozuar nga kryeinspektori i këtij inspektorati”.

Neni 2

Në nenin 22 pika 14 ndryshohet si më poshtë:

“14. Njofton brenda 5 ditëve inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e masave përkatëse, kur vëren shkelje të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, që kanë të bëjnë me KTP-në, KTZ-në dhe shkelje të rregullave të sigurimit teknik. Për rastet kur gjatë akteve të kontrollit vëren shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit, njofton në mbledhjen më të afërt KRRT-në, e cila merr menjëherë në shqyrtim këto shkelje. KRRT-ja vendos miratimin ose jo të ndryshimeve në projekt dhe njofton inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e vendimit përkatës.”.

Neni 3

Në nenin 22/1 pika 13 ndryshohet si më poshtë:

“13. Njofton brenda 5 ditëve inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e masave përkatëse, kur vëren shkelje të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, që kanë të bëjnë me KTP-në, KTZ-në dhe shkelje të rregullave të sigurimit teknik. Për rastet kur gjatë akteve të kontrollit vëren shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit, njofton në mbledhjen më të afërt KRRT-në, e cila merr menjëherë në shqyrtim këto shkelje. KRRT-ja vendos miratimin ose jo të ndryshimeve në projekt dhe njofton inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për marrjen e vendimit përkatës.”.

Neni 4

Në nenin 28, në fjalinë e parë, fjalët “pranë organeve të Policisë së Ndërtimit” zëvendësohen me fjalët “pranë inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut”.

Neni 5

Në nenin 54 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parafundit fjalët “organet e Policisë së Ndërtimit” zëvendësohen me fjalët “inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut”.

2. Në paragrafin e fundit fjalët “Policia e Ndërtimit” zëvendësohen me fjalët “inspektorati

ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut.”.

Neni 6

Në nenin 59 fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Me kalimin e këtij afati, ato prishen nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut, në bazë të vendimit të KRRT-së.”.

Neni 7

Në nenin 75 paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Vënia e gjobës, prishja e objektit dhe kthimi i truallit në gjendjen e mëparshme realizohen në bazë të vendimit të dhënë nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut. Ekzekutimi i vendimit bëhet nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut, me ndihmën e organeve dhe të subjekteve të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 8

Në nenin 78 fjalia e dytë dhe e tretë ndryshohen si më poshtë:

“Seksioni i urbanistikës në bashki/komunë/qark, Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, policia bashkiake dhe personat e tjerë të interesuar, kur vërejnë ndërtime të kundërligjshme, njoftojnë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut, i cili, pas marrjes së njoftimit ose me nismën e vet, vendos menjëherë pezullimin e ndërtimit të kundërligjshëm dhe masën përkatëse, sipas nenit 81 të ligjit “Për urbanistikën” dhe legjislacionit në fuqi.”.

Neni 9

Në nenin 79 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“KRRT-ja jep lejen e ndërtimit, kur ndërtimi plotëson kërkesat e këtij ligji. Në rast të kundërt, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut merr vendim për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm.”.

2. Fjalia e fundit shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 80 fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Në rastet kur zbatimi i procedurave të neneve 75 dhe 79 pengohet nga kundërvajtësit, duke sjellë apo që mund të kenë pasoja për rendin publik, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut thërret në ndihmë forcat e rendit publik.”.

Neni 11

Neni 81 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 81

Përveç detyrimeve që përmbajnë këto dispozita, shkelja dhe kryerja e veprimeve të kundërligjshme, që përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e urbanistikës, dënohen me gjobë si më poshtë:

- Për nenet 34, 56, 57, 58 me shumën 50 000 lekë deri në 200 000 lekë.
- Për nenet 60, 61, 63 me shumën 200 000 lekë deri në 500 000 lekë.
- Për nenet 66, 67, 73 me shumën 500 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.
- Për nenet 75, 77, 78 me shumën 2 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.
- Për nenin 54 masa e dënimit me gjobë është sa vlera e ndërtimit jashtë projektit të miratuar,

që llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit, të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave.
Gjoha vendoset nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut.”.

Neni 12

Neni 82 shfuqizohet.

Neni 13

Në nenin 83 fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:
“Ankimi në gjykatë kundër vendimeve të KRRT-ve dhe të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut nuk pezullon ekzekutimin e tyre.”.

Neni 14

Neni 84 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 84

Gjobat, dëmshpërblimet dhe shpenzimet e prishjes, të përcaktuara në këtë ligj, paguhen nga kundërvajtësit brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut ose nga data kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamatë 2 për qind në ditë deri në një muaj. Pas kalimit edhe të këtij afati (një muaj), inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut kërkon ekzekutimin e tij, sipas procedurave të ligjit “Për kundërvajtjet administrative” dhe më pas në rrugë gjyqësore, sipas ligjeve në fuqi. Gjobat, shpërblimet dhe shpenzimet paguhen në zyrën e financës së organit të pushtetit vendor.”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5565, datë 4.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9844, datë 17.12.2007

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 8 "E ardhura e tatueshme" shtohet shkronja "gj" me këtë përmbajtje:
"gj) të ardhurat e tatueshme, të realizuara gjatë periudhës tatimore nga ato subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, që kanë një qarkullim më të madh se 2 milionë lekë deri në 8 milionë lekë në vit, të cilat llogariten si diferencë ndërmjet të ardhurave, gjithsej, me shpenzimet e njohura, të specifikuara në nenin 12/2 të këtij ligji."

Neni 2

Në nenin 11, në fund të pikës 1, fjalët "në paragrafin 2 të këtij ligji" bëhen "në paragrafin 2 të këtij neni".

Neni 3

Pas nenit 11 shtohen nenet 12, 12/1, 12/2, 12/3, 12/4, 12/5 dhe 12/6, si më poshtë:

"Neni 12

Të ardhurat e tatueshme nga veprimtaria e biznesit të vogël

1. Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8 000 000 lekë dhe jo më pak se 2 000 000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale.

2. Të ardhurat, gjithsej, nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme etj.

Neni 12/1

Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të bizneseve të vogla, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, është 10 për qind.

Neni 12/2

Shpenzimet e njohura

Për efekt të përcaktimit të së ardhurës së tatueshme, subjekteve të taksës vendore të biznesit të vogël do t'u njihen si shpenzime nga të ardhurat, gjithsej, të gjitha shpenzimet e kryera ose të lindura gjatë periudhës tatimore, që janë tërësisht të lidhura me qëllimin e biznesit.

Neni 12/3

Shpenzimet e panjohura

1. Për efekt të përcaktimit të së ardhurës së tatueshme, nuk njihen shpenzimet e mëposhtme:

- a) kostoja e blerjes dhe e përmirësimit të tokës dhe të truallit;
- b) kostoja e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të veprimtarisë, të cilat amortizohen, në përputhje me nenin 22 të këtij ligji;
- c) vlera e shpërblimeve në natyrë;
- ç) kontributet vullnetare të pensioneve;
- d) interesat e paguar, të cilët tejkalojnë normën mesatare të interesit 12-mujor të kredisë, për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë;
- dh) gjobat, kamatëvonesat dhe kushtet e tjera penale;
- e) krijimi ose rritja e rezervave dhe e fondeve të tjera speciale, përveç rasteve të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore;
- ë) tatimi mbi të ardhurat personale dhe ato nga biznesi;
- f) shpenzimet për përfaqësim dhe për pritje-përcjellje, të cilat e tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;
- g) shpenzimet e konsumit personal, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave;
- gj) shpenzimet, të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore. Për kufijtë e përcaktuar për qëllime tatimore në ligjin nr.7892, datë 21.11.1994 "Për sponsorizimet", nuk njihen si shpenzime të njohura shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shumat e sponsorizuar për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit;
- h) shpenzimet për dhurata;
- i) çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi;
- j) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit të faturave nga persona të tretë, por të palikuiduara brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi;
- k) humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit, tej normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;
- l) shpenzimet për pagat, shpërblime dhe çdo formë tjetër të të ardhurave personale, të cilat lidhen me të ardhurat me marrëdhëniet me punësimin, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë dhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- ll) shumat e paguara në cash, mbi kufijtë e përcaktuar në nenin 36/1 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- m) nëse gjatë periudhës tatimore, huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën e kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkaluar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm;
- n) borxhi i keq, nëse nuk plotësohen tri kushtet e përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji. Një borxh i keq, që është mbledhur, duhet të përfshihet si e ardhur në çastin e mbledhjes;
- nj) shpenzimet për udhëtime, ushqim, akomodim dhe lëvizje duhet të kufizohen te shumat e specifikuar me udhëzim të Ministrit të Financave;
- o) shpenzimet për asetet kapitale, përveç shpenzimeve për tokën, veprat e artit dhe pasuri të tjera, që nuk amortizohen, në pronësi të taksapaguesit dhe të përdorura për veprimtaritë e biznesit të taksapaguesit, do të mbulohen, gjatë kohës, përmes shpenzimeve të amortizimit, sipas përcaktimeve të mëposhtme:
 - i) kostot e blerjes ose ndërtimit, kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve, me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, në mënyrë lineare, me 5 për qind;
 - ii) amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind;
 - iii) kompjuterat, sistemet e informacionit, produktet software dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave amortizohen në bazë të vlerës së grupit, me 25 për qind;
 - iv) të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë, me 20 për qind.

2. Baza e amortizimit është vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore, duke i shtuar koston e blerjes apo të krijimit të aktivit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë, gjatë periudhës tatimore dhe duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve, për shkak të forcave të

tjera madhore ose të shndërrimeve të tjera, të pavullnetshme, gjatë periudhës tatimore. Në rastin kur baza e amortizimit është një shumë negative, kjo shumë i shtohet të ardhurës së tatueshme dhe baza e amortizimit merret zero. Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 5 000 lekë, e gjithë baza e amortizimit është një shpenzim i zbritshëm i veprimtarisë. Në rastin kur bëhet rivlerësim i aktiveve të veprimtarisë nuk lejohet të llogaritet amortizimi për shumën e rivlerësuar.

Neni 12/4

Mbajtja regjistrimeve

Librat dhe regjistrimet, që kërkohet të mbahen nga tatimpaguesit, janë: libri i shitjes (i qarkullimit), libri i blerjeve, libri i shpenzimeve dhe i të ardhurave dhe libri i aktiveve të biznesit, të cilat do të përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 12/5

Kreditimi i tatimit

Taksa vendore mbi biznesin e vogël, e paguar gjatë vitit pranë organeve të qeverisjes vendore, është e kreditueshme (e zbritshme) përkundrejt tatimit për t'u paguar, të llogaritur si shumëzim i të ardhurës së tatueshme, në deklaratën tatimore vjetore, me shkallën tatimore.

Neni 12/6

Deklarimi

1. Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën "gj" të nenit 8 të këtij ligji, është i detyruar që, deri më 31 mars të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, e ardhura e tatueshme, tatimi për t'u paguar, taksa vendore, e paguar gjatë periudhës tatimore pranë organeve të qeverisjes vendore, çdo shumë për t'u paguar apo për t'u rimbursuar, si dhe çdo hollësi tjetër e kërkuar nga Ministri i Financave në udhëzimin për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Deklarata dorëzohet në bankat, me të cilat administrata tatimore ka marrëveshje për pranimin e deklaratave dhe të pagesave dhe ajo shoqërohet me çdo kërkesë për rimbursim apo me çdo shumë për t'u paguar.

2. Tatimi, i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore tatimore, pakësuar me kreditimin e tatimit, përcaktuar në nenin 12/5 të këtij ligji, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore tatimore."

Neni 4

Në nenin 21 pika 1, shkronja "o" shfuqizohet.

Neni 5

Bartja e humbjeve, inventari, çështjet, që lidhen me kundërvajtjet administrative, penalitetet dhe ankimin, bëhen sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2008.

**Shpallur me dekretin nr.5566, datë 4.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.9845, datë 17.12.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9584, DATË 17.7.2006 “PËR
PAGAT, SHPËRBLIMET DHE STRUKTURAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA
KUSHTETUESE DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA TË PAVARURA, TË KRIJUARA
ME LIGJ”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 pika 1, pas fjalëve “Këshilli i Lartë i Drejtësisë” shtohen fjalët “Avokati i Prokurimeve”.

Neni 2

Në lidhjen nr.1, që përmendet në nenin 4, bëhen këto ndryshime:

a) në klasifikimin “F”, pika 5 shfuqizohet;

b) në klasifikimin “E”, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
“4. Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës 0,55”.

c) në klasifikimin “d”, pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:
“9. Avokati i Prokurimeve 0,6”.

Neni 4
Dispozitë kalimtare

Për Avokatin e Prokurimeve, ky ligj i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të tij.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5567, datë 4.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.9846 datë 17.12.2007

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË PARCELAVE NË EKONOMINË
PYJORE KRASTË-KRUJË, QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E FABRIKËS SË
ÇIMENTOS E PËR KARIERA NGA SHOQËRIA "GENER 2" SHPK**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISE

VENDOSI:

Neni 1

Për parcelat pyjore, që do të përdoren nga shoqëria "GENER 2" shpk për:
1. ndërtimin e fabrikës së çimentos dhe tullave të lehtësuara, me sipërfaqe 11,67 ha;
2. karierë guri gëlqeror, me sipërfaqe 127,42 ha;
3. karierë argjile, me sipërfaqe prej 55,78 ha;
gjithsej 194,87 ha, të cilat ndodhen në ekonominë pyjore Krastë-Krujë, sipas tabelave 1 e 2 dhe hartës, që i bashkëlidhen këtij ligji, të veprohet si më poshtë:
a) sipërfaqja për ndërtimin e fabrikës të hiqet nga fondi pyjor kombëtar;
b) sipërfaqet, që do të përdoren për kariera, të mbeten në fondin pyjor kombëtar, duke u regjistruar në zërin kadastral sipërfaqe joproduhuese pyjore.

Neni 2

Të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit pyjor kombëtar, që përftohen nga heqja dhe ndryshimi i zërit kadastral të këtyre parcelave, sipas nenit 1 të këtij ligji, si dhe të përfundojnë procedurat e pagesave të sipërfaqes totale prej 194,87 ha, sipas vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

Neni 3

Brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, shoqëria "GENER 2" shpk të pyllëzojë 200 ha pyje në parcelat e degraduara pyjore, sipas përcaktimit të drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor.

Neni 4

Për karierat, shoqëria "GENER 2" sh.p.k. të zbatojë kërkesat për rehabilitimin dhe riveshjen

me bimësi pyjore, të përcaktuara në lejen mjedisore dhe në lejet e shfrytëzimit.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5568, datë 4.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

TABELA 1

SIPËRFAQET QË HIQEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR DHE NGA ZËRI KADASTRAL
PYLL NË SIPËRFAQE JOPYJORE SIPAS KËRKESËS SË SHOQËRISË “GENER 2” SHPK

Nr	Kërkesa	Ekonomia pyjore	Ngastra, N/ngastra	Sip. e kërkuar ha	Përdorimi i territorit	Forma e qeverimit
1	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	58 a 1	26,79	Pyll prodhues	Shkurre
2	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	59 a 1	9,25	Pyll prodhues	Shkurre
3	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	66 b 1	1,71	Pyll prodhues	Shkurre
4	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	67 a 1	2,22	Pyll prodhues	Shkurre
5	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	68 a 1	4,81	Pyll prodhues	Trungishte
6	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	68 d 1	2,00	Pyll prodhues	Trungishte
7	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	69	15,00	Pyll prodhues	Shkurre
8	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	70 a	24,00	Pyll prodhues	Shkurre
9	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	71 a 1	12,20	Pyll prodhues	Shkurre
10	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	75 a 1	5,96	Pyll prodhues	Shkurre
11	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	75 b	4,25	Pyll prodhues	Shkurre
12	Karierë guri gëlqeror	Krastë- Krujë	76 a 1	15,98	Pyll prodhues	Trungishte
	Shuma 1			124,17		
1	Karierë argjile	Krastë- Krujë	62 a 1	6,18	Pyll prodhues	Shkurre
	Shuma 2			6,18		
1	Fabrika	Krastë- Krujë	63 a 1	6,19	Pyll prodhues	Shkurre
2	Fabrika	Krastë- Krujë	64 a 1	1,93	Pyll prodhues	Shkurre
	Shuma 2			8,12		
	TOTALI			138,47		

TABELA 2

SIPËRFAQET PYJE DHE KULLOTA NË PRONËSI SHTETËRORE TË VËRTETUARA ME
DOKUMENTE TË LËSHUARA NGA ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME KRUJË

Nr.	Zona kadastrale	Kërkesa	Përdorimi i territorit	Pronësia	Sip. ha
1	Verjon -ZK3783,trualli fabrikës	Truall fabrike	Pyll, kullotë	Shtetërore	3,55
2	Halilaj-ZK 1921, argjila	Karierë argjile	Pyll, kullotë	Shtetërore	49,6
3	Halilaj-ZK 1921, Prr.Dallxhikut	Karierë gëlqerore	Pyll, kullotë	Shtetërore	3,25
	TOTALI				56,4

PLAN VENDORJIA E POLIGONEVE
NE EKONOMISE PYJORE
"KRASTE KRUE"



LIGJ
Nr.9847, datë 17.12.2007

**PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT NDËRMJET
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË
“GENER 2” SHPK DHE NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË TOKËS BUJQËSORE, TË
PËRCAKTUAR NË KËTË MARRËVESHJE, NË TOKË PËR SHFRYTËZIM MINERAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet “Marrëveshja minerare e shfrytëzimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “GENER 2” sh.p.k.”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Sipërfaqes së tokës bujqësore, brenda koordinatave të përcaktuara në ankesin nr.1 të kësaj marrëveshjeje, t’i ndryshojë destinacioni nga tokë bujqësore në tokë për shfrytëzim minerar.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5569, datë 4.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE MINERARE E SHFRYTËZIMIT

E lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e përfaqësuar nga z. Kristo Rodi, Drejtor i Përgjithshëm, i autorizuar nga Ministri z.Genc Ruli.

dhe

“GENER 2” sh.p.k. shoqëri e themeluar në bazë të legjislacionit shqiptar me vendim nr.30145, datë 3.9.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me adresë: rruga “Mustafa Matohiti”, pallati nr.7, kati 2, zyra 7, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z.Bashkim Ulaj,

duke pasur parasysh që:

- Në kuadrin e zhvillimit ekonomik të vendit, Qeveria Shqiptare i ka dhënë prioritet zhvillimit të zonave industriale lidhur me aktivitetin minerar;

- Legjislacioni në fuqi, rregullon aktivitetet minerare dhe marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe personave juridikë, që synojnë të përfitojnë nga legjislacioni minerar. Të gjitha të drejtat minerare të siguruara në përputhje me ligjin “Ligji minerar i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994, të ndryshuar dhe ushtrimi i çdo aktiviteti minerar në Shqipëri bazohen në legjislacionin shqiptar dhe do të ushtrohen në përputhje me të;

- Qeveria e Shqipërisë mirëpret investitorët vendas dhe të huaj për shfrytëzimin e çdo vendburimi minerar, me qëllim nxjerrjen e mineraleve duke përfshirë kërkimin, shfrytëzimin dhe zbulimin brenda një depozite minerare;

- Qeveria e Shqipërisë është deklaruar për një politikë të tërheqjes dhe mbështetjes së investimeve vendase dhe të huaja. Në zbatim të këtyre politikave, ajo është e angazhuar t'i inkurajojë dhe mbështesë ata sa më gjerësisht që të jetë e mundur, nëpërmjet sigurimit të bashkëpunimit të të gjitha autoriteteve shtetërore apo institucioneve të tjera nën kontrollin e saj, veçanërisht që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre duke iu përgjigjur brenda një kohe sa më të shkurtër kërkesave të personave juridikë sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë. Ajo angazhohet që të bëjë të mundur që këto organe shtetërore dhe institucione të tjera të mos vonojnë në mënyrë të paarsyeshme aprovimin e tyre, për të siguruar zhvillimin e infrastrukturës së duhur nga Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për të mundësuar investimin për ngritjen dhe vënien në funksionim të një fabrike për prodhimin e tullave të lehta dhe të një fabrike për prodhimin e çimentos;

- Qeveria e Shqipërisë njeh si të vlefshme lejen minerare, e cila jepet nga ministri që mbulon veprimtarinë minerare, duke bërë të mundur zhvillimin e aktivitetit minerar që lidhet me kërkimin, zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve;

- "Ligji minerar i Shqipërisë" nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, përcakton marrëdhënien ndërmjet shtetit shqiptar dhe personave juridikë që synojnë të përfitojnë të drejta në bazë të dispozitave të tij dhe të kryejnë aktivitete minerare;

- Ministri është i autorizuar të negociojë për nënshkrimin e një marrëveshjeje lehtësuese për investime të lartpërmendura me Zotëruesin e lejes minerare, marrëveshjeje e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe në vijim nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;

- Ministri ka negociuar Marrëveshjen me Zotëruesin e lejes minerare.

Zotëruesi i lejes minerare:

- Është seriozisht i interesuar të ushtrojë aktivitetin minerar dhe për përdorimin e produkteve minerare për qëllime industriale si lëndë të parë për prodhimin e tullave të lehta dhe të çimentos;

- Ka ndërmarrë studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt (siç përcaktohet në ligjin minerar të sipërpërmendur) dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e tullave të lehta dhe të fabrikës për prodhimin e çimentos për qëllime industriale;

- Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të ndërmarrë ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikave dhe zhvillimin e infrastrukturave lidhur me to, duke investuar një shumë prej rreth 15 000 000.00 (pesëmbëdhjetë milionësh) dollarësh amerikanë për fabrikën e prodhimit të tullave dhe 197 000 000.00 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë) dollarë amerikanë për fabrikën e prodhimit të çimentos, sipas planeve të investimit të parashikuara në nenin 3 të Marrëveshjes;

- Do të bëjë përpjekjet më të mira për ta zhvilluar aktivitetin minerar me qëllim që ta bëjë këtë biznes konkurrues dhe efikas në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar.

Palët:

Bien dakord që të bashkëpunojnë për shfrytëzimin e materialeve ndërtimore (shtufit, argjilës dhe gurit gëlqeror) në zonën Kodra e Zezë (Kunjes), në zonën e argjilave Bacung dhe në zonën e përroit të Dallxhikut, Fushë-Krujë, në përputhje me lejet minerare me të cilat është pajisur shoqëria e sipërpërmendur, zotëruese e lejes minerare dhe sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1

Përkufizime

Kudo ku janë përdorur termat e mëposhtëm në këtë Marrëveshje, respektivisht ato do të kenë kuptimet si vijon:

- Marrëveshje minerare e shfrytëzimit: Kjo Marrëveshje me të gjitha përkufizimet;

- Zotëruesi i lejes minerare: Shoqëria "GENER 2" sh.p.k.;

- Periudha e shfrytëzimit minerar: Periudha kohore e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për 99 vjet;

- Zona minerare: Sipërfaqja e kërkuar nga Zotëruesi i lejes minerare për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt, në zonën e gëlqeroreve, përroi i Dallxhikut, Fushë-Krujë, siç përcaktohet në lejen e shfrytëzimit minerar nr.1045, datë 31.7.2007, në zonën e Argjilave Bacung, Fushë-Krujë, siç përcaktohet në lejen e shfrytëzimit minerar nr.1072, datë 21.9.2007 dhe në zonën e ranoreve, Kodra e Zezë (Kunjes) Fushë-Krujë, siç përcaktohet nga leja e shfrytëzimit minerar nr.1073, datë 21.9.2007. Koordinatat që përcaktojnë sipërfaqet e zonave minerare jepen në aneksin nr.1

bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje;

- Projekt: Studimi tekniko-ekonomik për shfrytëzimin mineral;
- Projekt investimi: Tërësia e masave siç parashikohen në nenin 3 të Marrëveshjes.

Neni 2

Objektivi i Marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshjeje do të jetë dhënia, Zotëruesit, e të drejtës për të ushtruar aktivitetet mineral, në zonën minerale gjatë periudhës së shfrytëzimit mineral dhe, gjithashtu përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të Palëve për përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 3

Kritere specifike të punimeve

Projektet e investimit të karrierve dhe dy fabrikave do të zbatohen nga Zotëruesi i lejes minerale për një kohëzgjatje maksimale prej 6 (gjashtë) vjetësh për secilën prej tyre, të cilat do të ndahen në 2 (dy) faza, plus një fazë të tretë të mirëmbajtjes deri në fund të periudhës së shfrytëzimit mineral.

I. Projekti i investimit për hapjen e karrierve dhe të fabrikës së prodhimit të çimentos:

Faza e parë

Punimet përgatitore për hapjen e karrierës së argjilës në zonën e argjilave Bacung, Fushë-Krujë dhe të karrierës së gurit gëlqeror në zonën përroi i Dallxhikut, Fushë-Krujë, do të kryhen gjatë një periudhe prej 6 (gjashtë) vjetësh.

Studimet teknike të karrierve, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e mineraleve me një investim të përafërt gjatë dy viteve të para prej 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) dollarësh amerikanë. Studimet teknike, projektimi dhe punimet përgatitore për hapjen e karrierve dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e çimentos kanë filluar. Blerja, montimi dhe fillimi i punës së impiantit të thyerjes që ndodhet në karrierë. Makineritë e lëvizshme.

Vlera e përafërt e investimit në vitin e tretë: 850 000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) dollarë dhe deri në përfundim të investimit: 7 000 000 (shtatë milion) dollarë specifikuar sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Aktiviteti	Vlera e investimit në milionë dollarë
2008-2009	Studimet teknike të karrierve, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e mineraleve.	0.45
2010-2011	Punimet në karriera për impiantin e thyerjes.	0.85
2011-2012	Pajisjet fikse, montimi dhe fillimi i punës. Pajisje të lëvizshme.	7

Faza e dytë

Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e çimentos do të bëhet paralelisht me fazën e parë dhe gjatë një periudhe totale prej 6 vjetësh, me një investim total prej rreth 188 700 000 (njëqind e tetëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind mijë) dollarësh.

Investimet që lidhen me karrierat do të kryhen paralelisht dhe do të përfundojnë jo më vonë se përfundimi i fabrikës për prodhimin e çimentos.

Investimet gjatë kësaj faze të dytë do të ndjekin radhën e treguar në tabelën në vijim:

Viti	Aktiviteti	Vlera në milionë dollarë
2010-2011	Mbyllja e marrëveshjes për ndërtimin e fabrikës së prodhimit të çimentos, pagesa për kontraktorin (5%).	8.2

	Mbyllja e projektit të rrugëve ndërmjet karrierave dhe fabrikës, si dhe midis fabrikës dhe rrugës nacionale, paraqitja e dokumenteve dhe marrja e lejes. Punimet për kampin e punëtorëve. Fillimi i punimeve për fjetoret (shtëpitë).	
2012	Pagesa për kontraktorin (20%). Punime dherash për fabrikën, fillimi i punimeve për rrugët e brendshme. Ndërtimi i themeleve. Punime të tjera. Instalimi i 40% të transformatorëve dhe rrjetit elektrik të tensionit të lartë. Ndërtimi i disa strukturave, mbarimi i konstruksionit të fabrikës, dhe çpimi për ujë. Punime të tjera.	36.1
2013	Punime dherash dhe punime përgatitore në karrierë për impiantin e thyerjes.	72.2
	Pagesa për kontraktorin (40%). Punime përgatitore dhe struktura. Fillimi i punimeve për rrugët e jashtme. Disenjimi i ndërtesave joproduuese, aplikimi te autoritetet për marrjen e lejes. Fillimi i punimeve për ndërtimin e ndërtesave në fjalë. 60% e transformatorëve dhe rrjetit elektrik të tensionit të lartë Konstruksione. Punime të tjera.	
2014	Përfundimi i punimeve për ndërtesat prej betoni dhe i ngritjes së strukturave të çelikut dhe pajisjeve. Pagesa e fundit për kontraktorin (35%). Mbarimi i ndërtimit të rrugëve të jashtme. Instalimet elektrike, elektronike dhe lidhja. Mbarimi i ndërtimit të disa ndërtesave joproduuese. Testi pa ngarkesë dhe i prodhimit. Fillimi i prodhimit. Çmobilizimi i kampit të punëtorëve. Të tjera.	72.2

Faza e tretë

Punimet për mirëmbajtjen dhe investimet për rrugët e brendshme të karrierave të argjilës në vendburimin e argjilave Bacung, Fushë-Krujë dhe gurit gëlqeror në vendburimin gëlqeror, përroi i Dallxhikut, Fushë-Krujë do të bëhen gjatë periudhës së mbetur deri në fund të shfrytëzimit minerar sipas nevojës.

Vlera e mirëmbajtjes dhe investimeve gjatë kësaj faze të tretë llogaritet mbi shumën prej 4 000 000 dollarësh në vit gjatë gjithë ekzistencës së aseteve.

Bilancet vjetore do të përdoren si dokumente për monitorimin e investimit.

II. Projekti i investimit për hapjen e karrierave dhe të fabrikës së prodhimit të tullave të lehta:

Faza e parë

Punimet përgatitore për hapjen e karrierave të shtufit në zonën Kodra e Zezë (Kunjes) Fushë-Krujë, do të kryhen gjatë një periudhe prej 6 (gjashtë) vjetësh.

Studimet teknike të karrierave, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e mineraleve me një investim të përafërt gjatë vitit të parë dhe të dytë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) dollarësh. Studimet teknike, projektimi dhe punimet përgatitore për hapjen e karrierave dhe ndërtimin e fabrikës për prodhimin e tullës kanë filluar. Blerja, montimi dhe fillimi i punës së impiantit të thyerjes që ndodhet në karrierë. Makineritë e lëvizshme.

Vlera e përafërt e investimit në vitin e tretë dhe të katërt: 6 000 000 (gjashtë milionë) dollarë dhe në vitin e pestë dhe të gjashtë: 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) dollarë specifikuar sipas tabelës së mëposhtme

Viti	Aktiviteti	Vlera e investimit në milionë dollarë
2008-2009	Studimet teknike të karrierve, studimet gjeologjike dhe gjeoteknike, shpimet dhe analizat e mineraleve	0.25
2010-2011	Punimet në karriera për impiantin e thyerjes	0.85
2011	Pajisjet fikse, montimi dhe fillimi i punës. Pajisje të lëvizshme	¹

Faza e dytë

Ndërtimi i fabrikës për prodhimin e tullave të lehta do të bëhet paralelisht me fazën e parë dhe gjatë një periudhe totale prej 6 vjetësh, me një investim total prej rreth 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) dollarësh.

Investimet që lidhen me karrierat do të kryhen paralelisht dhe do të përfundojnë jo më vonë se përfundimi i fabrikës për prodhimin e tullave.

Investimet gjatë kësaj faze të dytë do të ndjekin radhën e treguar në tabelën në vijim:

Viti	Aktiviteti	Vlera në milionë dollarë
2010	Mbyllja e marrëveshjes për ndërtimin e fabrikës së Tullave, pagesa për kontraktorin (10%). Mbyllja e projektit të rrugëve ndërmjet karrierve dhe fabrikës, si dhe midis fabrikës dhe rrugës nacionale, paraqitja e dokumenteve dhe marrja e lejes. Punimet për kampin e punëtorëve. Fillimi i punimeve për fjetoret (shtëpitë).	0.90
2011	Pagesa për kontraktorin (20%). Punimet dherash për fabrikën, fillimi i punimeve për rrugët e brendshme. Ndërtimi i themeleve. Punime të tjera. Instalimi i pjesshëm i transformatorëve dhe rrjetit elektrik të tensionit të lartë. Ndërtimi i disa strukturave, mbarimi i konstruksionit të fabrikës, dhe shpimi për ujë. Punime të tjera.	2.60
2012	Punime dherash dhe punime përgatitore në karrierë për impiantin e thyerjes. Pagesa për kontraktorin (35%). Punime përgatitore dhe struktura. Fillimi i punimeve për rrugët e jashtme. Disenjimi i ndërtesave joproduuese, aplikimi te autoritetet për marrjen e lejes. Fillimi i punimeve për ndërtimin e ndërtesave në fjalë. Konstruksione. Punime të tjera.	3.90
2013-2014	Përfundimi i punimeve për ndërtesat prej betoni dhe i ngritjes së strukturave të çelikut dhe pajisjeve. Pagesa e fundit për kontraktorin (35%). Mbarimi i ndërtimit të rrugëve të jashtme.	6.50

¹ Kjo fazë e projektit të investimit plotësohet nga pajisjet dhe investimi në projektin e fabrikës së çimentos, që do të realizohet paralelisht nga Zotëruesi i lejes minerare.

	Instalimet elektrike, elektronike dhe lidhja. Mbarimi i ndërtimit të disa ndërtesave joprodhuese. Testi pa ngarkesë dhe i prodhimit. Fillimi i prodhimit. Çmobilizimi i kampit të punëtorëve. Të tjera.	
--	--	--

Faza e tretë

Punimet për mirëmbajtjen dhe investimet për rrugët e brendshme të karriera të shfrytëzimit të materialit ranor në vendburimin ranor Kodra e Zezë (Kunjes), Fushë-Krujë do të bëhen gjatë periudhës së mbetur deri në fund të shfrytëzimit mineral sipas nevojës.

Vlera e mirëmbajtjes dhe investimeve gjatë kësaj faze të tretë llogaritet mbi shumë prej 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) dollarësh në vit të gjatë gjithë ekzistencës së aseteve

Bilancet vjetore do të përdoren si dokumente për monitorimin e investimit.

Neni 4

Fillimi i ndërtimit

Zotëruesi i lejes minerare duhet të fillojë ndërtimin e fabrikës për prodhimin e tullave dhe të fabrikës për prodhimin e çimentos brenda 24 (njëzet e katër) muajve, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Një fillim i tillë do të kushtëzohet nga disponueshmëria e tokës për qëllimet e ndërtimit të fabrikave për kohëzgjatjen e kësaj lejeje minerare të zgjatur, si dhe dhënien e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshme për ndërtimin e fabrikës për prodhimin e tullave të lehta dhe të fabrikës së çimentos nga të gjitha autoritetet kompetente.

Neni 5

Detyrimet dhe të drejtat e Zotëruesit të lejes minerare

Zotëruesi i lejes minerare është i detyruar:

- Të zbatojë punimet për shfrytëzimin e karriera në përputhje me projektet e investimit, sipas dispozitave të nenit 3, nëse autoritetet shtetërore kompetente nuk e kanë refuzuar padrejtësisht dhënien e të gjitha licencave dhe lejeve të nevojshme si për karrierat, ashtu edhe për fabrikën për prodhimin e tullave dhe për fabrikën e çimentos.

- Të sigurojë ecurinë normale dhe drejtimin e punimeve, ndërsa do të mbajë ministrinë vazhdimisht të informuar, përse i përket procesit mineral, në përputhje me kërkesat e legjislacionit mineral në fuqi.

Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë:

Në përputhje me nenin 69 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994, i ndryshuar, Palët me qëllim që të sigurojnë një zhvillim të mirëbalancuar të aktivitetit mineral të shfrytëzimit në Shqipëri (hapjen e karriera për materiale ndërtimi) dhe mbrojtjen në mënyrë të përshtatshme të investimit të Zotëruesit të lejes minerare dhe aktivitetin e Zotëruesit të lejes minerare në kuadër të investimit për ndërtimin dhe vënien në funksionim të dy fabrikave për prodhimin e tullave të lehta dhe për prodhimin e çimentos, bien dakord që Zotëruesi i lejes minerare për një periudhë prej 99 vjetësh nga firmosja e kësaj Marrëveshjeje dhe aprovimi i saj nga Kuvendi i Shqipërisë do të ketë të drejtën ekskluzive të ushtrojë këtë aktivitet shfrytëzimi mineral në zonën minerare, sipas përcaktimeve të mësipërme.

Neni 6

Të drejta dhe detyrimet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

- Ministria garanton se ajo ka kompetenca dhe autoritet ligjor të plotë për të firmosur këtë Marrëveshjeje.

- Ministria garanton përdorim të pacenuar dhe të papenguar të sipërfaqeve të tokës, objekt i kësaj Marrëveshjeje, për periudhën e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje. Ministria merr përsipër të ndihmojë dhe të asistojë Zotëruesin e lejes minerare, për marrjen në rrugë ligjore të të gjitha lejeve dhe licencave për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikave dhe të lidhjes rrugore të tyre me

karrierat dhe tregun, nga autoritetet shtetërore apo institucione të tjera nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të ndihmojë që këto leje të jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Ministria garanton që sipërfaqet e karrierave dhe të fabrikave do të jenë të lira nga pretendime të palëve të treta për ndonjë pengesë apo barrë të çfarëdo lloji, bazuar në shkresat nr.496/1, 497/1, 497/2, 497/3 prot., datë 8.8.2007 të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Krujë. Ministria në bashkëpunim me autoritetet qeveritare kompetente, merr përsipër të ndihmojë dhe të asistojë zgjidhjen e çdo problemi që lidhet me pretendimin e personave të ndryshëm për sa më sipër, gjatë realizimit të objektit të kësaj Marrëveshjeje.

- Ministria garanton të drejtën ekskluzive të Zotëruesit të lejes minerare të kryejë aktivitet ekonomik në zonën e shfrytëzimit dhe përpunimit mineral të përcaktuar më sipër dhe merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë Zotëruesin e lejes minerare për zgjidhjen e konflikteve nga pretendimet e padrejta të të tretëve ndaj saj, lidhur me problemet e mbrojtjes së ambientit, apo dhe pretendimet të tjera të padrejta nga të tretët për zhdëmtime të natyrave të ndryshme.

Neni 7

Kohëzgjatja e shfrytëzimit mineral

Ministria i garanton Zotëruesit të lejes minerare të drejtën e shfrytëzimit të mineraleve në zonën minerare për një kohëzgjatje prej 99 vjetësh. Kjo periudhë kohore do të fillojë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Programi i punimeve

Zotëruesi i lejes minerare garanton se do të kryejë investimet e parashikuara në planet e ndërtimit dhe të shfrytëzimit me qëllim realizimin e objektit të kësaj Marrëveshjeje. Projektet do të zbatohen sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas planeve përkatëse të investimit të paraqitur.

Ndryshime në planet e punimeve dhe të investimeve do të bëhen vetëm me pëlqimin e dyja Palëve. Ndryshimi mund të jetë objekt i vlerësimeve që rrjedhin nga ngjarje të ndodhura, nga mundësia dhe nevojat për të përmirësuar efektshmërinë e planeve të shfrytëzimit dhe të qëllimit të tyre.

Nuk konsiderohen ndryshime, rastet kur punimet e parashikuara në secilin projekt investimi realizohen me fonde investimesh më të vogla ose anasjelltas.

Në çdo rast, Zotëruesi i lejes minerare nuk do të detyrohet të kryejë investime më të mëdha se ato të përcaktuara.

Neni 9

Përfundimi i Marrëveshjes së shfrytëzimit mineral

Ministria mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje, kur ajo gjykon se kanë ndodhur shkelje të vazhdueshme të detyrimeve të ndërmarra nga Zotëruesi i lejes minerare, të tilla që mund të bëjnë të pamundur vijimin e punimeve dhe Zotëruesi i lejes minerare nuk do të ketë kryer të paktën 80% të projekteve të investimit, në përfundim të kohëzgjatjes maksimale të realizimit të tyre. Kur vihen re shkelje, ministria duhet të njoftojë Zotëruesin e lejes minerare rreth këtyre shkeljeve dhe të presë 30 ditë për një përgjigje shpjeguese.

Cenimi i Marrëveshjes në lidhje me një projekt, nuk cenon vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me projektin tjetër.

Mosplotësimi i ndonjërit nga detyrimet, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk duhet të konsiderohet që është një shkelje e kësaj Marrëveshjeje për sa kohë që kjo mospërmbyllje, vjen si pasojë e një ngjarje që konsiderohet si forcë madhore dhe, kur është provuar se Pala e prekur nga kjo ngjarje: a) ka marrë të gjitha masat parandaluese të arsyeshme, si dhe të gjitha hapat e nevojshme për të zbatuar termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje; dhe b) ka informuar menjëherë palën tjetër për ndodhinë e kësaj ngjarjeje.

“Një ngjarje forcë madhore” do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë apo kombinim i tyre që pengon plotësisht apo pjesërisht secilën nga palët për plotësimin e detyrimeve, sipas kësaj

Marrëveshjeje, vetëm nëse dhe në atë masë, që një ngjarje apo rrethanë e tillë është përtej kontrollit të arsyeshëm direkt apo indirekt të Palës së prekur dhe nuk mund të ishte parandaluar nga çfarëdo mase e arsyeshme që kjo Palë mund të kishte ndërmarrë.

Ngjarja forcë madhore përfshin ngjarjet në vijim, por pa u kufizuar vetëm me to, me kusht që ato të plotësojnë termat e sipërpërmendur:

i) çdo akt lufte (i deklaruar apo jo), luftë civile, pushtim, konflikt i armatosur apo veprim i armikut të jashtëm, kryengritje apo terrorizëm që përfshijnë apo ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Shqipërisë;

ii) revolucion, protesta, rebelim ose çdo lloj revolte civile, akte terrorizmi apo sabotazhi, të cilat në çdo rast përfshijnë apo ndikojnë direkt Republikën e Shqipërisë;

iii) greva të shpërndara gjerësisht dhe/ose në shkallë, politike, kombëtare;

iv) kontaminim bërthamor, kimik, ose biologjik të cilat direkt apo indirekt ndikojnë sipërfaqen objekt të kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur shkaku i këtij kontaminimi vjen si rezultat i veprimeve të shoqërisë ose kontraktorëve të saj;

v) epidemitë ose infeksionet, të cilat direkt ose indirekt ndikojnë në zonën e koncesionit.

Në raste vonesash të shkaktuara nga ministria ose nga ndonjë organ tjetër shtetëror, i cili kryen funksionet e tij në lidhje të drejtpërdrejtë me lëshimin e licencave dhe lejeve të tjera ndërtimore të nevojshme për ndërtimin dhe vënien në funksionim të fabrikës për prodhimin e tullave të lehta dhe të fabrikës për prodhimin e çimentos, ose vonesa të pajustificuara të shkaktuara nga organe të tjera qeveritare gjatë kryerjes së funksioneve që lidhen me këtë Marrëveshje dhe nuk janë nën kontrollin e shoqërisë, periudha e vonesës nuk do të llogaritet në kuadrin e afateve kohore të vendosura më sipër.

Në rastet e forcës madhore, afatet kohore të përmendura në nenin 3 të mësipërm për Zotëruesin e lejes minerare do të shtyhen në përputhje me të, por në asnjë rast kjo nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës së shfrytëzimit mineral, e cila mund të shtyhet vetëm sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Kontrolli dhe investimi

Ministria ka të drejtën dhe detyrimin që të kontrollojë rregullisht zbatimin e Marrëveshjes sipas kushteve të parashikuara në të dhe në përputhje me detyrimet e saj që rrjedhin nga “Ligji mineral i Shqipërisë” nr.7796, datë 17.2.1994.

Ministria dhe Zotëruesi i lejes minerare do të përcaktojnë së bashku mënyrën më të mirë të kontrollit, duke siguruar në të gjitha rastet që ky aktivitet nuk do të paraqesë ndërhyrje të paarsyeshme në zbatimin e projekteve. Zotëruesi i lejes minerare do të japë çdo shpjegim teknik që kërkohet.

Zotëruesi i lejes minerare do të vërë në dispozicion të Ministrisë pasqyrat financiare vjetore të tij, të audituara dhe të hartuara në përputhje me standardet e kontabilitetit, me qëllim verifikimin e zbatimit të investimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në çdo rast kur, Ministria identifikon shkelje, ajo do t’ia komunikojë me shkrim, në mënyrë mjaft të hollësishme, vërejtjet dhe gjetjet e saj Zotëruesit të lejes minerare, me kërkesën që punimet duhet të vazhdohen sipas përcaktimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Ligji i aplikueshëm

Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Ministria garanton se të drejtat e Zotëruesit të lejes minerare sipas kësaj Marrëveshjeje që lidhen me shfrytëzimin e karrierave për një periudhë prej 99 vjetësh dhe përdorimi i tokës për një periudhë prej 99 vjetësh do të zgjasë dhe do të vijojnë të qëndrojnë në fuqi, pavarësisht çdo ndryshimi të dispozitave ligjore që lidhen me to, të aplikueshme në Shqipëri që do të hyjnë në fuqi, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur këto ndryshime ligjesh apo ligje të reja që hyjnë në fuqi favorizojnë Zotëruesin e lejes minerare.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Asnjë mosmarrëveshje ndërmjet Palëve, nuk do të ndërpresë zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve të Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në rastin e ndonjë mosmarrëveshjeje, e cila mund të lindë nga dhe në lidhje me vlefshmërinë, fuqinë, interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok ndërmjet palëve do të zgjidhet përfundimisht nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar, në përputhje me rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), nga një apo tre arbitra, që do të emërohen sipas rregullave të sipërpërmendura.

Vendi i arbitrazhit do të jetë në Paris, Francë dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

Neni 13

Bashkëpunimi

Ministria dhe Zotëruesi i lejes minerare bien dakord që të bashkëpunojnë me qëllimin për të garantuar zbatimin e projekteve, siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera sipas ose në lidhje me këtë kontratë duhet të dorëzohen ose të dërgohen me postë rekomande me kthim përgjigjeje ose teleks ose faks Palës që duhet të marrë njoftimin në adresën e caktuar këtu më poshtë ose në një adresë tjetër të specifikuar nga kjo Palë.

Adresat janë:

Ministria

- Emri i Palës: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

- Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

Shoqëria

- Emri i Palës: “Gener 2”

- Adresa: rruga “Mustafa Matohiti”, pallati nr.7, kati 2, Tiranë.

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet i vlefshëm, në rast se nuk është pranuar me shkrim nga të dyja Palët.

Neni 14

Vlefshmëria e pavarur e dispozitave të Marrëveshjes

Në rast se një dispozitë ose detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje është i pavlefshëm ose i pazbatueshëm në një juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, nuk do të preket nga një fakt i tillë.

Palët do të përpiqen të zbatojnë një dispozitë të pazbatueshme ose të pavlefshme, në masën më të madhe të mundshme për të arritur qëllimin e kësaj dispozite.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas firmosjes së saj nga Palët dhe, pasi ajo të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe më pas të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7796, datë 17. 2.1994, i ndryshuar.

Për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës, e përfaqësuar
me autorizimin e
Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës nga:
z. Kristo Rodi
Drejtor i Përgjithshëm

Për shoqërinë “Gener 2”
Përfaqësuar nga administratori
i shoqërisë
z. Bashkim Ulaj

Aneksi nr1

Kordinatat e sipërfaqeve dhene me leje minerare shfrytezimi sipas mineraleve:

A- Gur Gelqeror

B- Argjila

C- Ranor

A- Kordinatat e sipërfaqes se gurit gelqeror sipas lejes minerare nr 1045

Pika	X	Y
1	4594815,00	4398660,00
2	4595200,00	4398095,00
3	4595509,00	4398217,00
4	4595576,00	4398781,00
5	4593700,00	4399950,00
6	4593700,00	4399250,00
7	4594325,00	4399000,00
8	4594625,00	4398520,00
Sipërfaqja = 1.395 000 m ² = (139.5 ha)		

B-Kordinatat e sipërfaqes së argjilave sipas lejes minerare nr 1072

Pika	X	Y
1	4592057,02	4397470,34
2	4592034,14	4397441,89
3	4592022,05	4397412,81
4	4592017,31	4397387,48
5	4592028,58	4397371,31
6	4592047,76	4397360,51
7	4592073,89	4397356,92
8	4592114,23	4397356,59
9	4592164,01	4397374,06
10	4592166,56	4397415,01
11	4592175,08	4397425,25
12	4592179,06	4397433,66
13	4592184,65	4397449,85
14	4592190,01	4397455,29
15	4592197,33	4397458,04
16	4592202,53	4397456,83
17	4592205,56	4397453,52
18	4592204,39	4397444,64
19	4592199,33	4397432,71
20	4592197,84	4397424,15
21	4592197,52	4397407,39
22	4592199,49	4397400,20
23	4592208,97	4397393,97
24	4592219,18	4397390,30
25	4592242,74	4397384,24
26	4592246,63	4397378,75
27	4592246,84	4397375,23
28	4592245,32	4397371,88
29	4592241,43	4397368,85
30	4592233,70	4397365,27
31	4592196,59	4397353,80
32	4592187,62	4397347,96
33	4592179,71	4397338,75
34	4592175,71	4397330,42
35	4592168,42	4397323,38

36	4592134,87	4397332,57
37	4592123,73	4397331,93
38	4592094,29	4397317,52
39	4592059,97	4397314,39
40	4592046,67	4397311,36
41	4592035,48	4397312,43
42	4592013,21	4397301,62
43	4591997,09	4397301,20
44	4591971,46	4397294,50
45	4591916,07	4397289,82
46	4591873,55	4397275,21
47	4591855,03	4397255,19
48	4591804,79	4397182,54
49	4591796,66	4397167,49
50	4591795,15	4397156,24
51	4591803,80	4397113,90
52	4591801,88	4397088,13
53	4591787,84	4397081,35
54	4591758,96	4397084,27
55	4591744,15	4397076,09
56	4591730,89	4397061,13
57	4591739,16	4397055,52
58	4591717,02	4397048,02
59	4591707,69	4397036,70
60	4591689,65	4397033,61
61 (34)	4591687,46	4397022,88
62 (35)	4592096,97	4396935,57
63	4592108,42	4396944,81
64	4592133,68	4396979,55
65	4592207,84	4397035,29
66	4592312,66	4396995,76
67	4592348,74	4396905,12
68	4592416,51	4396907,14
69	4592419,81	4396911,35
70	4592691,98	4396702,86
71	4592733,24	4396653,09

72	4592756,79	4396688,62
73	4592759,02	4396717,52
74	4592781,26	4396760,82
75	4592769,41	4396774,38
76	4592740,01	4396781,68
77	4592734,59	4396788,18
78	4592734,93	4396800,45
79	4592742,34	4396821,35
80	4592752,44	4396838,92
81	4592748,58	4396849,97
82	4592730,87	4396862,55
83	4592719,33	4396864,76
84	4592700,54	4396871,72
85	4592698,10	4396875,29
86	4592702,06	4396880,76
87	4592719,31	4396892,16
88	4592726,53	4396902,57
89	4592723,73	4396927,01
90	4592723,09	4396943,04
91	4592703,47	4397027,75
92	4592692,70	4397049,04
93	4592670,25	4397063,62
94	4592669,13	4397068,15
95	4592690,84	4397093,53
96	4592689,15	4397123,62
97	4592686,42	4397131,04
98	4592675,68	4397136,55
99	4592646,28	4397129,71
100	4592619,42	4397127,34
101	4592609,78	4397136,69
102	4592602,80	4397175,85
103	4592594,76	4397200,49
104	4592591,20	4397205,86
105	4592585,89	4397209,07
106	4592579,68	4397210,12
107	4592574,67	4397209,28
108	4592569,61	4397206,83

109	4592550,98	4397187,32
110	4592541,64	4397182,54
111	4592516,97	4397162,55
112	4592512,29	4397162,55
113	4592508,03	4397166,38
114	4592505,17	4397172,37
115	4592507,01	4397198,13
116	4592496,94	4397212,10
117	4592478,50	4397214,23
118	4592445,97	4397210,20
119	4592441,98	4397224,27
120	4592451,09	4397235,56
121	4592481,31	4397243,11
122	4592495,35	4397236,71
123	4592506,90	4397237,15
124	4592512,48	4397244,17
125	4592513,42	4397277,92
126	4592517,25	4397284,89
127	4592527,65	4397289,16
128	4592533,54	4397289,41
129	4592610,51	4397280,23
130	4592633,04	4397285,54
131	4592638,77	4397292,77
132	4592626,04	4397328,69
133	4592625,83	4397336,00
134	4592662,72	4397402,09
135	4592671,32	4397426,67
136	4592675,08	4397453,44
137	4592671,86	4397462,58
138	4592674,97	4397490,58
139	4592697,12	4397519,19
140	4592705,71	4397526,84
141	4592715,12	4397584,95
142	4592718,21	4397651,43
143	4592723,44	4397659,40
144	4592730,78	4397677,85
145	4592740,50	4397676,07

146	4592736,73	4397687,97
147	4592725,23	4397705,63
148	4592721,46	4397714,96
149	4592708,39	4397731,40
150	4592711,40	4397751,46
151	4592710,79	4397780,53
152	4592701,78	4397812,75
153	4592689,41	4397831,68
154	4592691,23	4397834,84
155	4592715,31	4397840,20
156	4592730,19	4397836,72
157	4592736,87	4397831,73
158	4592743,55	4397746,47
159	4592790,56	4397685,05
160	4592795,61	4397671,58
161	4592807,77	4397651,95
162	4592818,17	4397597,98
163	4592818,32	4397592,49
164	4592822,80	4397576,95
165	4592843,41	4397545,87
166	4592845,37	4397532,49
167	4592827,60	4397482,89
168	4592825,63	4397444,57
169	4592818,76	4397418,58
170	4592812,92	4397363,52
171	4592818,00	4397352,31
172	4592823,38	4397348,28
173	4592848,47	4397342,90
174	4592858,78	4397343,20
175	4592898,58	4397359,18
176	4592928,98	4397359,43
177	4592974,43	4397391,03
178	4593014,88	4397437,10
179	4593026,90	4397445,37
180	4593061,28	4397446,29
181	4593080,42	4397451,83
182	4593096,15	4397489,58

183	4593102,86	4397573,95
184	4593117,32	4397611,33
185	4593128,28	4397624,01
186	4593144,83	4397630,86
187	4593108,70	4397657,16
188	4593105,50	4397694,33
189	4593115,07	4397745,72
190	4593106,94	4397775,37
191	4593110,76	4397786,21
87 F	4593105,46	4397834,76
88 F	4593082,10	4397886,00
89 F	4592631,79	4397886,00
Sipërfaqja = 715861 m ² = (71.58 ha)		

C-Kordinatat e sipërfaqes së ranoreve sipas lejes minerare nr 1073

Pika	X	Y
1	4592347,73	4396502,60
2	4592331,94	4396507,31
3	4592272,38	4396491,30
4	4592241,99	4396494,83
5	4592219,57	4396511,06
6	4592191,77	4396545,22
7	4592172,85	4396556,42
8	4592082,73	4396518,56
9	4592006,73	4396553,72
10	4591940,63	4396574,13
11	4591918,74	4396591,81
12	4591908,57	4396615,42
13	4591919,83	4396626,69
14	4591909,61	4396644,49
15	4591862,04	4396612,40
16	4591845,54	4396591,03
17	4591804,16	4396581,18
18	4591777,61	4396614,65
19	4591745,18	4396607,46
20	4591733,39	4396597,22
21	4591643,59	4396669,55
22	4591633,52	4396720,23
23	4591661,95	4396781,07
24	4591599,81	4396800,68
25	4591572,29	4396821,67
26	4591579,94	4396869,68
27	4591629,74	4396836,69
28	4591638,22	4396845,18
29	4591630,58	4396856,30
30	4591648,96	4396878,44
31	4591651,64	4396936,49
32	4591643,43	4396951,54
33	4591677,00	4396971,65
34	4591687,46	4397022,88

35	4592096,97	4396935,57
36	4591983,20	4396843,73
37	4591959,87	4396804,14
38	4592046,14	4396779,26
39	4592050,14	4396761,19
40	4592059,21	4396766,18
41	4592075,04	4396761,08
42	4592072,92	4396744,02
43	4592114,17	4396727,44
44	4592121,85	4396749,18
45	4592188,45	4396791,86
46	4592245,82	4396805,96
47	4592351,55	4396798,32
48	4592350,75	4396788,35
49	4592297,12	4396786,20
50	4592298,71	4396711,83
51	4592376,73	4396719,05
52	4592378,85	4396725,49
53	4592386,06	4396725,65
Siperfaqja 232 290 m ² = 23.22 ha		

LIGJ
Nr.9848, datë 17.12.2007

PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHITUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “ Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në kreun V, në nenin 57, pas pikës së fundit të paragrafit të parë shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

“ - Kur fatura tatimore, e lëshuar nga blerësi për shitësin fermer, nuk përmban të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 58/4 të këtij ligji.” .

Neni 2

Në kreun VI, pas nenit 58 shtohen nenet 58/1, 58/2, 58/3 dhe 58/4, si më poshtë:

“Neni 58/1

Skema e kompensimit të fermerëve

1. Për fermerët, të cilët, në kuadër të veprimtarisë së tyre, në njërën nga fushat e prodhimit bujqësor e blegtoral, furnizojnë me këto produkte një person të tatueshëm, sipas kuptimit të këtij ligji, zbatohet skema e kompensimit të akorduar. Ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për bujqësinë e blegtorinë, përcakton me udhëzim listën e produkteve të përfshira në këtë skemë.

2. Kompensimi i akorduar i paguhet shitësit fermer nga blerësi, person i tatueshëm, përkundrejt furnizimeve të kryera.

3. Kompensimi i akorduar është i barabartë me produktin e përqindjes fiks të kompensimit me vlerën e furnizimit dhe llogaritet, për çdo furnizim të fermerit, për personin e tatueshëm. Kompensimi mbulon një pjesë të TVSH-së së paguar prej fermerëve, të përfshirë në çmimin e blerjes së mallrave e shërbimeve, që u janë furnizuar atyre, për nevoja të veprimtarisë ekonomike, bujqësore e blegtorale.

Neni 58/2

Përqindja e kompensimit

Kompensimi është në masën 6 për qind.

Neni 58/3

Detyrime të fermerit

Fermerët përfitojnë të drejtën e kompensimit kur:

a) nuk janë regjistruar dhe nuk detyrohen të regjistrohen si persona të tatueshëm, sipas këtij ligji;

b) bëjnë furnizimin me mallra, me prejardhje nga puna e tyre, kryer në njërën nga fushat e

përcaktuara në pikën 1 të nenit 58/1 të këtij ligji;

c) mallrat ua furnizojnë të tretëve, persona të tatueshëm;

ç) janë pajisur me një kod personal, lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 58/4

Detyrime të personit të tatueshëm

1. Blerësi, person i tatueshëm, lëshon një faturë tatimore për shitësin fermer, për çdo furnizim të marrë prej tij. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi, për llogari të shitësit fermer, mbi të cilën zbatohet përqindja fikse e kompensimit.

2. Forma dhe përmbajtja e faturës janë përcaktuar në nenin 36 të këtij ligji, në përputhje me natyrën e furnizimit.

Në krye të saj vendoset shënimi “ Faturë e lëshuar nga blerësi” dhe në të duhet të shënohen këto të dhëna:

a) emri, adresa, NIPT-i i personit të tatueshëm blerës;

b) emri, mbiemri, adresa, kodi personal i fermerit shitës;

c) data, kur lëshohet fatura;

ç) përshkrimi i çdo lloj malli të furnizuar;

d) sasia e mallrave të furnizuara;

dh) çmimi për njësi i çdo lloj malli të furnizuar;

e) vlera e furnizimit;

ë) përqindja e kompensimit të paguar;

f) shuma e kompensimit të paguar;

g) vlera e përgjithshme e paguar për atë furnizim.

3. Kompensimi, që personi i tatueshëm blerës i ka paguar shitësit fermer, vlerësohet si TVSH-ja e kreditueshme për personin e tatueshëm, sipas kushteve të nenit 33 të ligjit dhe deklarohet në periudhën tatimore, kur është lëshuar fatura.

4. Në qoftë se fatura nuk përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara, sipas pikës 2 të këtij neni, personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin e paraqitur në të dhe detyrohet të paguajë një dënim të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2008.

**Shpallur me dekretin nr.5570, datë 4.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM

Nr.152, datë 27.12.2007

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR FILLIMIN E NDJEKJES PENALE NDAJ

DEPUTETIT LULZIM BASHA

Në mbështetje të nenit 73 pikat 2 dhe 4 të Kushtetutës dhe të nenit 118 pika 4 e Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Lulzim Basha, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

DEKRET Nr.5557, datë 27.12.2007

PËR LEJIM LENIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. Rajmond Bujar Agolli | 17. Artan Tosun Çela |
| 2. Elton Nevruz Heri | 18. Andi Vehip Bakiri |
| 3. Sindy Elton Heri | 19. Besnike Sherif Bardhi |
| 4. Alex Elton Heri | 20. Man Arif Hoxhaj |
| 5. Salvator Prend Tufa | 21. Vjollca Man Hoxhaj |
| 6. Lerida Ilir Rustemaj | 22. Ilir Man Hoxhaj |
| 7. Arben Isuf Lenz-Margjeka (Margjeka) | 23. Martin Dhimo Gogollari |
| 8. Shaje Ismail Trögner (Xhebrahimi) | 24. Angela Besnik Idrizi |
| 9. Edison Sefedin Tare | 25. Artan Eqrem Bekteshi |
| 10. Shefqet Ali Zalla | 26. Vladimir Ali Haxhiu |
| 11. Julian Shefqet Zalla | 27. Sajmir Hysen Zaimi |
| 12. Tobias Shefqet Zalla | 28. Artur Adli Baholli |
| 13. Raimonda Perikli Zalla (Vasili) | 29. Kujtim Fehmi Hyka |
| 14. Gleton Anesti Lena | 30. Sokol Ibrahim Hoxha |
| 15. Rezart Albert Laçi | 31. Flora Bajram Bellovoda (Likaj) |
| 16. Blerina Shaban Gojani (Merlika) | 32. Stefan Dhimitraq Bellovoda |
| 33. Bruno Dhimitraq Bellovoda | |
| 34. Kiti Dhimitraq Bellovoda | |
| 35. Mirela Gani Poch (Muçaj) | |
| 36. Dritan Feriz Hyseni | |
| 37. Kudrete Asllan Etemi (Rudi) | |
| 38. Bashkim Col Buçpapaj | |
| 39. Fatmir Murat Doshiani | |

40. Rudin Ruzhdi Kruja
41. Blerim Luan Luani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.5558, datë 27.12.2007

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|--|
| 1. Hamid Selman Sallagaj | 10. Tahsin Süleyman Albayrak |
| 2. Liliana Andrei Sino (Ermurachi) | 11. Xhafer Musli Kastrati |
| 3. Recep Zafer Duran | 12. Flurije Dinë Kastrati (Bajraktari) |
| 4. Burnist Nuhi Hamidi | 13. Korab Xhafer Kastrati |
| 5. Fatmire Imer Baftiri (Jusufi) | 14. Jetmir Xhafer Kastrati |
| 6. Bardhe Ibush Xhoi (Marmullaku) | 15. Fitore Xhafer Kastrati |
| 7. Guiseppe Francesco Suverato | 16. Laura Gheorghe Basri (Costrăș) |
| 8. Shefqet Bajrush Bucaliu | 17. Robert Charles Butler |
| 9. Roza Besim Malsori | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.5559, datë 27.12.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.5351, DATË 11.6.2007 “PËR KRIJIMIN E SEKSIONEVE TË VEÇANTA PENALE PËR GJYKIMIN E TË MITURVE PRANË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE”

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 13, pika 4 të Kodit të Procedurës

Penale, me propozim të Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Të krijohen seksionet e veçanta penale për gjykimin e të miturve, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, si më poshtë:

- Paragrafi 1 i nenit 1 të dekretit ndryshohet, si më poshtë:

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Tiranë, Krujë, Kurbin, Mat, Bulqizë dhe Dibër.

- Paragrafi 3 i nenit 1 të dekretit ndryshohet, si më poshtë:

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Shkodër, Lezhë, Mirditë, Malësi e Madhe, Pukë, Tropojë, Kukës dhe Has.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 4.1.2008
Doli nga shtypi më 4.1.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë